

LIBËR ME VLERË PËR NDRIÇIMIN E HISTORISË SË SHTYPIT SHQIPTAR

(Kosovar Basha, *The development of the albanian press in SFR Yugoslavia: (1974-1991): (cultural, educational and scientific aspects)*, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2022, 376 f.)

Autori i kësaj monografie është bashkëpunëtor shkencor për shek. XX, në Institutin e Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë. Kjo është tema e tij e doktoratës e mbrojtur në Institutin e Historisë Nacionale pranë Universitetit “Shën Qirili dhe Metodi”, më 3 shkurt 2021, me komision të përbërë nga: prof. dr. Katerina Mirçevska (mentor), prof. dr. Silvana Sidorovska - Çupovska, prof. dr. Dragica Popovska, prof. dr. Todor Çepreganov dhe prof. dr. Neven Radiçeski.

Monografia ka hyrjen dhe katër kapituj, burimet dhe literatura e përdorur. Kjo monografi është fryt i një pune hulumtuese në Bibliotekën Kombëtare “Pjetër Bogdani” të Republikës së Kosovës. Në hyrje autori i analizon gazetat në gjuhën shqipe duke filluar prej gazetës “Flamuri i Arbërit” prej rilindësit arbëresh Jeronim de Rada, më 23 gusht 1848, “Drita” e Sofjes, “Dielli” e botuar më 1909 në Boston, pastaj revistat dhe gazetat ndërmjet dy luftërave botërore. Gjatë Luftës së Dytë Botërore në Lëvizjen Antifashiste në Kosovë është botuar gazeta “Zani” dhe në Shqipëri “Zëri i popullit”. Ndërkaq në Tetovë, më 1944 do të botohet gazeta “Zani i Sharrit” e udhëhequr prej avokatit Shaip Kamberi dhe Azem Moranës, një prej udhëheqësve të organizatës kombëtare Nacional Demokratike Shqiptare (NDSH).

Në kapitullin e parë autori shkruan për mbledhjen e dytë të KAÇKJ-së. Autori i analizon Kushtetuten e parë të vitit 1945, e cila ka qenë e shkruar si model i Kushtetutës së BRSS-së prej vitit 1936, e vitit 1953, 1963 dhe vitit 1974. Ai përmend emrat e gazetave të përditshme jugosllave, që lirisht mund të krahasoheshin me gazetën në gjuhën shqipe “Rilindja”. Në të njëjtin kapitull, autori në mënyrë studioze i paraqet ngjarjet kryesore, si: masakrën e Tivarit, Rezolutën e Informbyrosë (1948), aksionin e mbledhjes së armëve, shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi, Plenumin IV të Brionëve (1 korrik 1966), ku u përjashtua prej të

gjitha funksioneve Aleksandër Rankoviqi dhe klika e tij hegjemoniste, diskutimet për statusin e Kosovës Republikë (prill-gusht 1966), demonstratat e vitit 1968 në Kosovë, demonstratat e Tetovës në dhjetor të vitit 1968 etj.

Në kapitullin e dytë paraqiten gazetat dhe revistat kryesore në Kosovë. Gazeta “Rilindja”, filloi botimin më 12 shkurt 1945, ndërsa si e përditshme do të fillojë të botohet më 29 nëntor të vitit 1958. Kjo gazetë është enciklopedi për të gjitha ngjarjet kryesore në të gjitha lëmitë si ajo politike, ekonomike, kulturore etj. Në të i botonin shkrimet profesorët universitarë, si: Ali Hadri, Zekeria Cana, Ëngjëll Sedaj, Hasan Mekuli, Vehap Shita, Pajazit Nushi, Skender Rizaj etj.

Në nënkapitullin tjetër është paraqitur revista për shkencë “Përparimi”. Ajo filloi të botohet në vitin 1946 dhe doli në shtypi deri në vitin 1991. Në të i botonin shkrimet elita intelektuale, si: Ali Dida, Fehmi Agani, Syrja Pupovci, Hasan Mekuli, Hajredin Hoxha, Skender Rizaj, Rifat Blaku, Shkëlzen Raça, Hivzi Islami, Jahja Drançolli etj. Revista “Fjala” filloi të botohet në vitin 1968 si revistë letrare. Kryeredaktori i parë ishte Ali Sutaj. Shkrimet e veta do t’i botojnë elita akademike prej Esad Mekulit, Muhamedin Kullashi, Zekeria Cana, Agim Vinca, Exhlale Dobruna - Salihu etj. Seminari ndërkombëtar për kulturën, gjuhën dhe letërsinë shqiptare filloi prej vitit 1974 me iniciatorin akademik Idriz Ajeti. Në të marrin pjesë historianë, letrarë, prej Kosove, Maqedonie, Shqipërie dhe prej qendrave albanologjike në Evropë.

Revista letrare “Jeta e re”, filloi të dalë në vitin 1949. Kjo revistë ka qenë fidanishte për zhvillimin e letërsisë shqipe prej Esad Mekulit si kryeredaktor i parë, akademik Rexhep Qosja, Hasan Mekuli dhe Ali Dedë Jasiqi, shkrimtarët prej Enver Gjerqekut, Din Mehmetit, Anton Pashku, Vehap Shita, Flora Brovina, akademikja Edi Shukriu, Ramiz Kelmendi etj. Kjo revistë kishte edhe rubrikën për letërsi ballkanike dhe botërore. Revista “Pionieri” do të jetë revistë për fëmijë ku do t’i botojnë shkrimet e veta shkrimtarët për fëmijë, si: Rexhep Hoxha, Qamil Batalli, Vehbi Kikaj etj. “Zëri i rinisë” ka filluar në vitin 1945 në Prishtinë. Në këtë revistë shkrimet e veta i botonin shkrimtarët më të njohur.

Në kapitullin e tretë janë përfshirë gazetat dhe revistat prej Republikës Socialiste të Maqedonisë. Pikësëpari gazeta “Flaka e vëllazërimit” në periudhën 1971-1991 do të botohet tri herë në javë. Ajo do ta ketë rubrikën e kulturës ku më së shumti do të shquhen Remzi Nesimi, Naxhi Ndoci, Teki Dervishi, Xhevat Gega, Rexhep Zllatku, Eshtref Aliu etj. Me shkrime historike do të merren dr. Masar Kodra, dr.

Reshat Nexhipi, dr. Shukri Rahimi, dr. Ramiz Abdyl, mr. Halim Purellku etj. Revista “Jehona” mund të krahasohet me “Përparimin” dhe me “Jetën e re”. Ajo ka filluar të dalë në vitin 1962 dhe prej vitit 1970 do të jetë në përbërje të “Flakës së vëllazërimit”. Aty do të botojnë shkrimtarë, si: Murat Isaku, Esad Mekuli, Asllan Selmani; historiani: Shukri Rahimi, akademikët Jashar Rexhepagiqi, Manol Pandevski, Aleksandar Hristov, mr. Tefik Raka etj. Revista u botua deri në vitin 1991. Revista për fëmijë “Gëzimi” do të botojë shkrime të Mehmedali Hoxhës, themeluesi i revistës dhe kryeredaktori i parë, Lutfi Rusi, Muharrem Shahiqi, Agim Deva, Vidoe Pogorec, Nuhi Vinca etj. Revista “Fatosi” do të fillojë të botohet më 1955, ku do të botojnë punimet e tyre letrare për fëmijë: Fatmir Gjata, Nexhati Zekeria, Darinka Janusheva, Miho Atanasovski, Vasil Kunovski, Nuhi Vinca, Ali Huruglica, Muharrem Shahiqi, Mustafa Spahiu etj. Të dy revistat ishin dritare kryesore për informacione arsimore dhe kulturore për fëmijët e kombësisë shqiptare në RS të Maqedonisë.

Në kapitullin e katërt autori i përfshinë revistat dhe gazetat në gjuhën shqipe në republikat e tjera, si: Serbi, Mal të Zi, Kroaci dhe Slloveni. Revista “Përpjekja” (Beograd) do t’i përfshijë studentët shqiptarë që do të studiojnë në Universitetin e Beogradit, ku do të botohet deri në vitin 1984. Revista “Koha” (e Malit të Zi) do të botohet në intervalin kohor 1978-1989, në Ulqin. Këtu do të botojnë: Vehap Shita, Basri Çapriqi, Agim Vinca etj. Revista “Alternativa” (Slloveni) do të botohet në Lubjanë në periudhën kohore 1989-1990. Kryeredaktor do të jetë Sali Kabashi. Revista do të jetë me karakter politik, kulturor, shkencor.

Gazeta “Dielli” u botua në Zagreb në vitet 1990-1991 dhe u udhëhoq nga një kolegjiu editorial. Në të u botuan artikuj dhe krijime të shkrimtarëve, si: Islamil Kadare, Rexhep Qosja, Agim Vinca, më pas shkrime arkeologjike e historike të Haxhi Mehmetajt, Hakif Bajramit etj.

Këto revista dhe gazeta luajtën një rol të madh në emancipimin dhe ngritjen e ndërgjegjes kombëtare, duke dhënë kontribut të çmuar në sferat kulturore, arsimore dhe shkencore. Libri është i botuar në gjuhën angleze që i jep një peshë ndërkombëtare monografisë së tij. I urojmë autorit suksese të mëtejshme, të mos i ndërpres punët studimore e kërkimore, në studimin e historisë dhe kulturologjisë sonë moderne dhe bashkëkohore, në zbulimin e fakteve dhe të dhënave të reja, sidomos të kësaj pjese bashkëkohore që tani kërkon më së shumti punë dhe përqendrim.

Jeton DOKO